



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT

AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DRJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 1730 Prot.

Tiranë, më 22.06. 2026

URDHËR

Nr. 142, datë 22.06.2026

PËR

SHPLLJEN E KONKURRIMIT PËR POZICIONET E PËRGJEGJËSIT TË SEKTORIT TË MONITORIMIT TË KURRIKULËS DHE ZHVILLIMIT PROFESIONAL NË ZYRAT VENDORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR LEZHË, LIBRAZHD.

Në mbështetje të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 18, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të vendimit nr. 99, datë 27.2.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, të ndryshuar, të urdhrit nr. 571, datë 18.11.2024 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar”, të urdhrit nr. 454, datë 13.9.2019, “Për miratimin e rregullores për rregullat dhe procedurat e konkurrimit për pranimin dhe lirin nga detyra të nëpunësve të DPAP-së në të gjitha nivelet e organizimit të saj”, të ndryshuar.

URDHËROJ:

1. Njoftimin e fillimit të procedurës së konkurrimit për pozicionet e Përgjegjës të sektorit të Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional në Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar Lezhë, Librazhd sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Procedura e konkurrimit për pozicionet e Përgjegjës të sektorit të Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional në Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar Lezhë, Librazhd do të kryhet në përputhje me kriteret dhe dokumentacionin që duhet

dorëzuar, sipas përcaktimeve të shtojcës nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

3. Afati i aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët për pozicionet e Përgjegjës të sektorit të Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional në Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar Lezhë, Librazhd do të jetë deri në datën 30.06.2026.
4. Publikimi i kriterëve dhe procedura që do të ndiqet për konkurrimin për pozicionet e Përgjegjës të sektorit të Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional në Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar Lezhë, Librazhd të bëhet në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, të Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar Lezhë, Korçë, të Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar Lezhë, Librazhd dhe në platformën puna.gov.al.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm, Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

ARTA BOLLANI



SHTOJCA I

SHPALLJE PËR POZICIONET E PËRGJEGJËSIT TË SEKTORIT TË MONITORIMIT TË KURRIKULËS DHE ZHVILLIMIT PROFESIONAL NË ZYRAT VENDORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR LEZHË, LIBRAZH.

Në mbështetje, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të pikës 13,14 të kreut III, të vendimit nr. 99, datë 27.2.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar”, të ndryshuar, të urdhrit nr. 571, datë 18.11.2024 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar” dhe të urdhrit nr. 454, datë 13.9.2019, “Për miratimin e rregullores për rregullat dhe procedurat e konkurrimit për pranimin dhe lirin nga detyra të nëpunësve të DPAP-së në të gjitha nivelet e organizimit të saj”, të ndryshuar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar shpall procedurat e konkurrimit për pozicionet:

- *Përgjegjës i sektorit të Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Lezhë.*
- *Përgjegjës i sektorit të Monitorimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Librazhd.*

I. KËRKESAT E PËRGJITHSHME QË DUHEN TË PLOTËSOHEN NGA KANDIDATËT JANË:

1. Të jetë shtetas shqiptar.
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
3. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
4. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
5. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje.
6. Të mos jetë larguar nga puna me masë disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

II. KËRKESAT E POSAÇME QË DUHEN TË PLOTËSOHEN NGA KANDIDATËT JANË:

1. Të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve, në arsimin e lartë, në fushën e edukimit.
2. Të ketë të paktën 5 vjet përvojë pune në institucionet e administratës publike, ose në institucionet që ofrojnë shërbime arsimore.
3. Zotërimi i gjuhëve të huaja dhe kualifikimet në fushën e kërkuar përbëjnë avantazh (dëshmi, certifikata).

III. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
2. Letër motivimi;
3. Diplomë arsimit të lartë (*Për diplomat e fituara jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njësimi nga institucioni përgjegjës për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë*);
4. Listë notash e noterizuar për ciklet e studimeve;
5. Certifikatë për gjuhët e huaja apo kualifikime të ndryshme;
6. Librezë pune (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
7. Fotokopje e kartës së identitetit;
8. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
9. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
10. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
11. Vërtetim nga prokuroria që nuk është në ndjekje penale;
12. Vërtetim nga gjykata që nuk ka proces penal.

Të gjitha dokumentat që janë fotokopje duhet të dorëzohen të njësuara me origjinalin.

Aplikimi i shoqëruar me dokumentet e sipërcituar do të dorëzohen nga kandidatët nëpërmjet shërbimit postar në Agjencinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, në adresën: Rruga "Aleksandër Moisiu", Tiranë.

IV. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I PUNËS PËR POZICIONIN E PËRGJEGJËSIT TË SEKTORIT TË MONITORIMIT TË KURRIKULËS DHE ZHVILLIMIT PROFESIONAL TË ZYRËS VENDORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR.

1. Harton planet dhe programet vjetore, mujore të sektorit dhe raporton tek eprori mbi realizimin e detyrave.
2. Miraton planet e punës të specialistëve të sektorit dhe ndjek realizimin e detyrave nga specialistët.
3. Harton plane dhe strategji për përmirësimin e cilësisë së sistemit arsimor parauniversitar në nivel ZVAP-je.
4. Identifikon nevojat për zhvillim profesional të mësuesve përmes pyetësorëve, bisedave me ta, pjesëmarrjes në mbledhjet e ekipeve lëndore, vizitave në institucione arsimore, vëzhgimeve të orëve mësimore, kryerjes me nxënësit të testeve të standardizuara e minitesteve, takimeve me prindër dhe organizma që i përfaqësojnë ato, si dhe me përfaqësues të tjerë të komunitetit;
5. Monitoron zbatimin e kurrikulës, metodologjitë dhe standardet që mbështesin dhe përmirësojnë procesin e ofrimit të shërbimit arsimor dhe raportojnë në AKAP dhe DRAP;

6. Mbikqyrin veprimtarinë e përditshme dhe funksionimin e institucioneve arsimore, përmbushjen e detyrave administrative dhe rregullsinë e procesit mësimor;
7. Vlerësojnë nevojat dhe problematikat gjatë ofrimit të shërbimit arsimor dhe propozojnë zgjidhjen e tyre;
8. Menaxhojnë dhe mbikëqyrin/kontrollojnë institucionet arsimore parauniversitare lidhur me zhvillimin e proceseve dhe veprimtarive mësimore;
9. Kryejnë miradministrimin e burimeve njerëzore për institucionet publike të arsimit parauniversitar në varësi të aftësive, kontributit të gjithsecilit dhe parimeve të drejtësisë e meritokracisë;
10. Bashkëpunojnë për ngritjen e rrjeteve profesionale të mësuesve si dhe përhapin praktikat dhe përvojat e suksesshme të mësuesve të institucioneve arsimore;
11. Vlerësojnë sipas afateve kohore të përcaktuara të dhënat e dërguara nga shkollat në kuadër të hartimit të kartës së performances;
12. Organizojnë dhe mbështesin shërbimin psiko-social në institucionet arsimore parauniversitare publike për evidentimin e problematikave psiko-sociale të fëmijëve/nxënësve dhe zgjidhjen e tyre;
13. Planifikojnë, organizojnë dhe realizojnë veprimtari plotësuese jashtëshkollore të miratuara në udhëzimet përkatëse;
14. Monitorojnë procedurat për përzgjedhjen, shpërndarjen dhe pajisjen e nxënësve me tekste shkollore dhe raportojnë në DRAP;
15. Organizojnë dhe mbështesin zhvillimin e provimeve dhe vlerësimeve kombëtare në arsimin parauniversitar;
16. Mbledh informacion mujor nga shkollat mbi gjendjen e mjeteve elektronike të TIK-ut dhe të laboratorëve të kompjuterëve, verifikon gjendjen dhe raporton në DRAP dhe AKAP;
17. Ndjek plotësimin nga shkollat të parapëlqimeve të nxënësve në kurrikulën me zgjedhje;
18. Grumbullon nga institucionet arsimore parauniversitare në varësi, të dhënat statistikore sipas kërkesave të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, të AKAP dhe DRAP;
19. Ofron shërbime ndaj qytetarëve.

V. VERIFIKIMI DHE SHQYRTIMI I DOKUMENTACIONIT DHE SHPALLJA E LISTËS PËRFUNDIMTARE

Në përfundim të afatit të aplikimit, Komisioni *ad-hoc* pas shqyrtimit të dosjeve të aplikantëve do të shpallë, brenda 3 (tre) ditëve pune listën e kandidatëve që plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të posaçme, në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar : (<https://arsimiparauniversitar.gov.al>).

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe/ose të posaçme do të njoftohen individualisht nga njësia e burimeve njerëzore, për shkaqet e skualifikimit, nëpërmjet adresës së e-mail të deklaruar nga çdo kandidat.

Kandidatët e skualifikuar kanë të drejtën e ankimit brenda 2 (dy) ditëve pune nga marrja dijeni për shkaqet e skualifikimit, nëpërmjet adresës së email-it të deklaruar prej tyre. Ankuesit do t'i kthehet përgjigje brenda 2 (dy) ditëve pune duke filluar nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

Lista përfundimtare e kandidatëve të kualifikuar do të shpallet brenda datës **10.07.2026**, në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar: (<https://arsimiparauniversitar.gov.al>). Në të njëjtën datë do të shpallet dhe njoftimi për datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet testimi me shkrim.

VI. FUSHAT E NJOHURIVE MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

1. Ligji nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
2. Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
3. Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
4. Ligji nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
5. Ligji nr. 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.
6. Vendimi nr. 99, datë 27.2.2019, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar”, të ndryshuar.
7. Vendimi nr. 621, datë 22.10.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”.
8. Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të ndryshuar.
9. Akte ligjore dhe nënligjore të MAS-it në fushën e arsimit parauniversitar dhe funksionimit të AKAP-it;

VII. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 pikë, të cilat ndahen:

1. Vlerësimi i testimit me shkrim, deri në 60 pikë.
2. Vlerësimi për intervistën e strukturuar me gojë, deri në 25 pikë.
3. Vlerësimi për jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

Për të kaluar në fazën e intervistës së strukturuar me gojë çdo kandidat duhet të marrë të paktën 30 (tridhjetë) pikë në testimin me shkrim.

VIII. SHPALLJA E FITUESIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Fituesi do të shpallet në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar:
<https://arsimiparauniversitar.gov.al>.

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet nëpërmjet adresës së tyre të email-it.

**Shënim: Afati i dorëzimit të dokumentacionit do të jetë nga data
22.06.2026 deri në datën 30.06.2026.**